

## Oshënare dëshmore Parashqevia / E Premtja. Hierodëshmorët Hermolau, Ermipi, Hermokrati.



E mërkurë, 26 korrik 2023 – Shenjtori i ditës.

DITË KRESHME

Oshënare dëshmore Parashqevia / E Premtja. Hierodëshmorët Hermolau, Ermipi, Hermokrati.

- OSHËNARE DËSHMORE PARASHQEVIA (E PREMTJA) -

Prindërit e saj të krishterë, Agathoni dhe Politia, jetonin në periferi të Romës në kohën e Adrianit (117-138). Duke qenë pa fëmijë më parë, e pritën si shpërblim të lutjeve të tyre dhe i dhanë emrin Parashqevi, sepse lindi të premtën (Parashqevi do të thotë: përgatitje). E edukuan me dashuri për Zotin. Vajza e virtytshme, e mençur dhe e bukur studionte Shkrimin e Shenjtë dhe frekuentonte shërbesat, derisa mbeti jetime. Atëherë pasurinë e saj ua dha të varfërve dhe vetë u rreshtua në një vëllazëri (murgeshash).

Më vonë, me bekimin e igumenes, doli në Romë dhe në krahinën e saj dhe predikonte Krishtin me sukses. Çifutët e patën zili dhe e paditën. Kështu u kap në kohën e Antoninit Piu (138 - 161). As me të butë dhe as egërsisht nuk mundën ta konvertonin dhe e torturuan: i veshën në kokë përkrenaren e skuqur, e varën nga flokët dhe e dogjën me llambadhe, e futën në zift dhe vaj të nxehtë, e ekspozuan

në një gjarpër të tmerrshëm, e kamxhikuan dhe e shtypën me një pllakë të rëndë në gjoks. Shumë herë virgjëresha nuk pësonte asgjë.

Një herë tjetër iu shfaq në burg një engjëll, madje edhe vetë Krishti, i Cili e lumëroi dhe e shëroi. Meqenëse ajo mbetej e pacenuar brenda vajit të përvëlur, pushtetari kërkoi që ta spërkaste, për të vërtetuar nëse ishte i nxehtë ose jo. Kur u spërkat, ai u verbua nga djegia. Iu lut oshënares i penduar dhe ajo e shëroi ndoshta për këtë arsye në kërkojmë ndërmjetimin e saj si mjeke okuliste.

Një herë tjetër, duke bërë shenjën e kryqit, bëri që të përplasej një gjarpër i frikshëm dhe një mrekulli e fundit e saj bëri që të bien dhe të copëtohen idhujt e një tempulli. Pas këtyre besoi një shumicë njerëzish. Kështu, për t'i dhënë fund mrekullive të saj, u detyruan t'i prisnin kokën.

Shenjtorja mjaft popullore nderohet edhe si mbrojtëse nga kolera dhe flama. Më 14.10.1442 një stuhi e tmerrshme do ta kishte përmbytur ishullin Hios, nëse ajo nuk do të ndërmjetonte në mënyrë efikase, siç e ëndërroi një hieromonak pasi u lut në një kishë të saj.

\* \* \* \*

- HIERODËSHMORËT HERMOLAU, ERMIPI, HERMOKRATI -

këta martirë të shenjtë e të lavdishëm ishin priftërinj në Nikomedi, në kohën e persekutimit të Maksimianit. Kur tirani dogji në kishën e tyre njëzet mijë të krishterë, ditën e Krishtlindjes, u fshehën në një banesë që të shpëtonin nga vdekja dhe e vazhduan më pas veprën e tyre apostolike.

Shën Pandeilemoni u arrestua dhe e nxorën para Maksimianit (27 korrik), i cili e pyeti se kush i kishte mësuar besimin e krishterë. Shenjtori, ngaqë nuk dinte të gënjente, i tregoi për mësuesin dhe atin e tij shpirtëror, priftin Hermola.

Ushtarët u sulën për të gjetur priftin e shenjtë dhe e kapën bashkë me Ermipin dhe Hermokratin. I nxorën në gjyq dhe rrëfyan se Krishti është Perëndia i vetëm, që u mishërua për shpëtimin tonë dhe u tallën me idhujt pa jetë dhe me ata që i adhuronin. Një tërmet tronditi qytetin dhe perandori u tha shenjtorëve se kjo ishte shenjë e zemërimit të perëndive. Por ata iu përgjigjën: "Si është e mundur që statujat e tua, që u shembën, të jenë perëndi?" Dhe i thanë tiranit se idhujt ranë e u bënë copë nga tërmeti. Në kulmin e tërbimit, Maksimiani e futi shën Pandeilemonin në burg dhe urdhëroi që t'u prisnin kokat në vend Ermolaut dhe shokëve të tij. Ata morën kurorën e fitores, duke paraprirë dishepullin e tyre në banesat qiellore.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)